



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI

DREJTORIA E KËRKIMIT SHKENCOR DHE PROJEKTEVE

245
24.10.2024

Nr. 244/6 Prot.

Tiranë, më 24/10 /2024

Lënda: Dërgohet Urdhëri i Rektorit të UPT-së për njohje dhe zbatim.

FAKULTETIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT
FAKULTETIT TË INXHINIERISË ELEKTRIKE
FAKULTETIT TË INXHINIERISË MEKANIKE
FAKULTETIT TË INXHINIERISË SË NDERTIMIT
FAKULTETIT TË GJEOLGJISË DHE MINIERAVE
FAKULTETIT TË INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE

Bashkëlidhur po ju dërgojmë Urdhërin e Rektorit Nr. 83, datë 24.10.2024, “Për hapjen e pranimeve në studimet e ciklit të tretë “Doktoratë” në Universitetin Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2024-2025”

Njësitë kryesore të UPT-së të marrin masat për zbatimin e këtij urdhëri.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,



REKTORI

Prof. Dr. Akli Fundo



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
REKTORI

Nr. 2414₅ Prot.

Tiranë, më 24 / 10 / 2024

URDHËR

Nr. 83, datë 24/10/2024

PËR

**HAPJEN E PRANIMEVE NË STUDIMET E CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË” NË
UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 112, datë 23.02.2018, i ndryshuar, Udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020, i ndryshuar, Rregulloren e Studimeve të Doktoratës në Universitetin Politeknik të Tiranës, Neni 5, si dhe në zbatim të Urdhërave të MAS Nr. 374, datë 23.07.2024, Nr. 383 datë 25.07.2024, Nr. 407 datë 01.8.2024, dhe shkresave të MAS, Nr. 3648/1 Prot., datë 01.10.2024, Nr. 6204/1 Prot., datë 21.10.2024,

URDHËROJ:

Hapjen e pranimeve në studimet e ciklit të tretë “Doktoratë” në Universitetin Politeknik të Tiranës në programet e studimit si më poshtë:

1. Doktoratë në “Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit”, nënfusha “Inxhinieri Informatike” dhe nënfusha “Telekomunikacion dhe Inxhinieri Informacioni” - Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit;
2. Doktoratë në “Inxhinieri Fizike” - Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike;
3. Doktoratë në “Inxhinieri Matematike” - Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike;
4. Doktoratë në “Inxhinieri Elektrike”, nënfusha “Automatizimi i Industrisë” - Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike;
5. Doktoratë në “Inxhinieri Ndërtimi”, nënfusha “Inxhinieri Mjedisi” – Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit;
6. Doktoratë në “Gjeodezi” - Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit;

7. Doktoratë në “Gjeologjia dhe Mjedisi” - Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave;
8. Doktoratë në “Inxhinieri Naftë dhe Gazi” - Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave;
9. Doktoratë në “Inxhinieri e Burimeve Minerare” - Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave;
10. Doktoratë në në “Inxhinieri Mekanike”, nënfisha “Inxhinieri Mekanike” dhe “Inxhinieri e Materialeve” – Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike.

Aplikimet e kandidatëve për studimet e ciklit të tretë “Doktoratë” në Universitetin Politeknik të Tiranës, do të kryhen nga data 28.10.2024 deri më datë 01.11.2024.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Akli Fundo

